PSH.nr.943/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068,dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi – Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Pro Medical & Andident" SH.P.K-Ferizaj, kundër vendimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: "Leta Med", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje bazike mjekësore Lot 3" me nr. të prokurimit: 634-20-3842-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Klinë", më datën: 04.12.2020, mori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Pro Medical & Andident"SH.P.K-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje bazike mjekësore Lot 3" me nr. të prokurimit: 634-20-3842-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Klinë".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje bazike mjekësore Lot 3" me nr. të prokurimit: 634-20-3842-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Klinë", dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Pro Medical & Andident"SH.P.K-Ferizaj aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Pro Medical & Andident"SH.P.K-Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.11.2020 me nr. 943/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me pajisje bazike mjekësore Lot 3" me nr. të prokurimit: 634-20-3842-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Klinë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 51, 59, 60, 65, 69 si dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 26.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoritetit kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk ka dorëzuar dokumente e kërkuar nga AK si: Garancioni 12 muaj për pajisjet MUNGON, CE dhe ISO për pozicioni 1 mungon pra Oksigjen koncentrator 3-5 litra MUNGON, Koha e liferimin duhet te jete 25 dite MUNGON, Oferta nga OE me kode te prodhuesit dhe emra përkatës ne detaje sipas specifikimit te kërkuar-MUNGON si dhe nuk ka ofruar katalog për pajisjet nga pozicioni 10-19, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Me ofertën e OE te rekomanduar për kontrate është dhënë edhe lista e çmimeve ne te cilën liste shkruan edhe Garancioni për 12 muaj për secilin pozicion, afat ky i kërkuar sipas dosje se tenderit. Meqenëse kjo liste dhe ky afat i garancionit është i dorëzuar me oferte nga OE i rekomanduar për kontrate, atëherë kjo është një dëshmi qe garancooni është ofruar sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Ndërsa certifikata CE dhe ISO për pozicionin 1 (Oksigjen koncentrator 3-5 litra) te listës se çmimeve nuk është e bashkangjitur ne ofertën e OE fitues. Koha e liferimit është caktuar nga AK ne dosjen e tenderit qe te jete 25 dite dhe OE i rekomanduar për kontrate ka plotësuar dosjen tenderit duke pasur parasysh edhe formularin e tenderit dhe është pajtuar me kushtet e dosjes se tenderit duke përfshirë edhe afatin e Liferimit prej 25 dite. Andaj kjo pike është përmbushur nga OE i rekomanduar për kontrate. Pjesa tjetër e këtij pretendimi ankimor qëndron, se OE i

rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar kodet e prodhuesit me emra përkatës sipas specifikimit teknik dhe mungon katalogu për pajisjet e ofruara nga pozicioni 10-19. Marre ne përgjithësi ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit nr. 6.4 sepse udhëheqësi i konzorciumit "Letamed" nuk ka dorëzuar vërtetimin e ATK-se dhe te gjykatës ekonomike, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar këto dy dokumente dhe te njëjtat janë te ngarkuar ne platformën elektronike te KRPP-se. Është plotësuar kërkesa e lartpërmendur e dosjes se tenderit. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr3

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes Për dorëzimin e referencave ose procesverbalet e pranimit teknik për projektet e kryera. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar vetëm listën e projekteve por nuk ka dorëzuar asnjë dëshmitë e përfundimit si Referencat ose procesverbalet e pranimit teknik pra siç ka kërkuar AK, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. OE fitues në ofertën e tij ka te bashkangjitur një liste te projekteve te kryera, mirëpo mungojnë referencat ose procesverbalet e pranimit punëve për kryerjen e projekteve ne mënyrë te kënaqshme. Pra nuk është plotësuar kjo kërkesë e dosjes se tenderit. Prandaj ky pretendim ankimor është i bazuar..

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Sa i përket pretendimit te fundit të OE ankues se AK nuk ka respektuar nenin 108/A te LPP-se sepse nuk kanë nxjerre vendim si përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim te datës 09.11.2020 edhe pas kalimit ta afatit ligjor, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. AK nuk i ka kthyer përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim te OE ankues, pra nuk është respektuar nenin 108/A i LPP-se. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontrate OE i cili nuk i ka plotësuar ne tërësi kërkesat e dosjes se tenderit. Po ashtu nga AK nuk është respektuar edhe neni 108/A i LPP-se sepse nuk ka nxjerre vendim si përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim te OE ankues. Si përfundim i shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të Aprovohet pjesërisht si e bazuar. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me pajisje bazike mjekësore" Lot 3" me nr. prok. 634-20-3842-121 në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 26.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 26.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Pro Medical & Andident"SH.P.K - Ferizaj, me datë: 29.11.2020, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje, Ne si OE pajtohemi pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues por sa përket Përgjigjes se pretendimin tone nr 2 nuk pajtohet sepse AK nuk ka paraqitur gjendje reale dhe faktike kur ne ku kemi pyetur AK sa kërkuar ndonjë dokumente nga OE i rekomanduar ka kthyer përgjigje citim" As një kërkesë e re nga Operatori I propozuar për kontrate nuk është kërkuar nga Komisioni I Ri –Vlerësimit" shiko edhe shkresën zyrtare / emaili te bashkangjitur pra përsëri AK nuk e ka respektua LPP dhe Vendim e OSHP . Ne i kemi shqetësim se AK nuk po shkreh interesim qe te zbatoj LPP dhe vendimin e OSHP dhe siç kemi cekur ne Ankesën tone AK fare nuk e ka shqyrtuar kërkesën e dyte për ri-shqyrtim qe kemi dorëzuar te AK. Ne kemi besim se Paneli shqyrtues i prokurimit publike te ketë parasysh pretendimet tone merr vendim konfrom LPP sepse ku aktivitet I prokurimi ka shume shkelje ligjore. Ju faleminderit dhe dëshiroj shëndet.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 04.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Pro Medical & Andident" SH.P.K-Ferizaj, se autoritetit kontraktues ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk ka dorëzuar dokumente e kërkuar nga AK si: Garancioni 12 muaj për pajisjet MUNGON, CE dhe ISO për pozicioni 1 mungon pra Oksigjen koncentrator 3-5 litra MUNGON, Koha e liferimin duhet te jete 25 dite MUNGON, Oferta nga OE me kode te prodhuesit dhe emra përkatës ne detaje sipas specifikimit te kërkuar-MUNGON si dhe nuk ka ofruar katalog për pajisjet nga pozicioni 10-19. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ne ofertën e OE të rekomanduar për kontrate është dhënë edhe lista e çmimeve ne te cilën liste shkruan edhe Garancioni për 12 muaj për secilin pozicion, afat ky i kërkuar sipas dosje se tenderit. Meqenëse kjo liste dhe ky afat i garancionit është i dorëzuar me oferte nga OE i rekomanduar për kontrate, atëherë kjo është një dëshmi që garancioni është ofruar sipas kërkesës se dosjes se tenderit. Ndërsa

certifikata CE dhe ISO për pozicionin 1 (Oksigjen koncentrator 3-5 litra) te listës se çmimeve nuk është e bashkangjitur ne ofertën e OE fitues. Koha e liferimit është caktuar nga AK ne dosjen e tenderit qe te jete 25 dite dhe OE i rekomanduar për kontrate ka plotësuar dosjen tenderit duke pasur parasysh edhe formularin e tenderit dhe është pajtuar me kushtet e dosjes se tenderit duke përfshirë edhe afatin e Liferimit prej 25 dite. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se kjo pike është përmbushur nga OE i rekomanduar për kontrate. Pjesa tjetër e këtij pretendimi ankimor qëndron, se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar kodet e prodhuesit me emra përkatës sipas specifikimit teknik dhe mungon katalogu për pajisjet e ofruara nga pozicioni 10-19. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Pro Medical & Andident" SH.P.K-Ferizaj, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit nr. 6.4 sepse udhëheqësi i konzorciumit "Letamed" nuk ka dorëzuar vërtetimin e ATK-se dhe te gjykatës ekonomike. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar këto dy dokumente dhe të njëjtat janë të ngarkuar në platformën elektronike të KRPP-së. Është plotësuar kërkesa e lartpërmendur e dosjes se tenderit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Pro Medical & Andident" SH.P.K-Ferizaj, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes për dorëzimin e referencave ose procesverbalet e pranimit teknik për projektet e kryera. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar vetëm listën e projekteve por nuk ka dorëzuar asnjë dëshmitë e përfundimit si referencat ose procesverbalet e pranimit teknik pra siç ka kërkuar AK. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE fitues në ofertën e tij ka te bashkangjitur një liste të projekteve të kryera, mirëpo mungojnë referencat ose procesverbalet e pranimit punëve për kryerjen e projekteve në mënyrë të kënaqshme. Pra nuk është plotësuar kjo kërkesë e dosjes se tenderit. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Pro Medical & Andident" SH.P.K-Ferizaj, se AK nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-se sepse nuk kanë nxjerre vendim si përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim te datës 09.11.2020 edhe pas kalimit të afatit ligjor. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK nuk i ka kthyer përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues, pra nuk është respektuar nenin 108/A i LPP-se. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontrate OE i cili nuk i ka plotësuar ne tërësi kërkesat e dosjes se tenderit. Po ashtu nga AK nuk është respektuar edhe

neni 108/A i LPP-se sepse nuk ka nxjerre vendim si përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim te OE ankues. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesdesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-Klinë";

1x1 OE "Pro Medical & Andident"SH.P.K –Ferizaj;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.